


Ja si na gjeni në Warendorf:



Waldenburger Straße 2
48231 Warendorf

Udhëtoni me autobus deri në stacionin e autobusëve „Kreishaus“. Ecni deri tek „Kreishaus“ në Waldenburgerstraße 2. Hyni në ndërtesë përmes hyrjes kryesore / hyrjes së vizitorëve. Ju lutemi të vini në numrin e dhomës E 0.148 në katin përdhes.

Terminin për bisedë këshilluese e keni të shkruar në ftesë.

Na telefononi, nëse keni pyetje!
Ju këshillojmë me dëshirë!
Telefoni jonë: 0 25 81 - 53 45 05

Botuesi:

Von-Geismar-Straße 12
59229 Ahlen
www.ki.kreis-waf.de

Kontakti:

eva-maria.sendt@kreis-warendorf.de
Tel.: 0 25 81 - 53 45 05



në gjuhët tjera
in other languages
en d'autres langues
en otros idiomas
diger dillerde
في لغات مختلفة

<http://www.waf.de/erstberatung>

Qendra integruese komunale ndihmohet nga ministria për shkollë dhe arsim e landit Nordrajn-Vestfallen:

Ministerium für
Schule und Bildung
des Landes Nordrhein-Westfalen



Ministerium für Kinder, Familie,
Flüchtlinge und Integration
des Landes Nordrhein-Westfalen



Gjendja: Dhjetor 2017

www.kreis-warendorf.de

Für die Zukunft gesattelt.

 **Kommunales
Integrationszentrum
Kreis Warendorf**

Konsultimi fillestar

i fëmijëve dhe adoleshentëve të sapo emigruar dhe familjeve të tyre

School Szkola École
Scuola Escola
Sola Chuo Skola
Dibistan Shkollë

 **KREIS
WARENDORF**


Prindër të dashur, të nderuar kujdestarë!

Jeni përzemërsisht të mirëseardhur në Rrethin Varendorf [Warendorf].


Të gjithë fëmijët dhe të rinjtë prej 6 deri 18 vjeç në Gjermani duhet të shkojnë në shkollë. Këtu i gjeni të gjitha informatat në lidhje me këtë çështje.

Fillimi është si vijon


1. Juve ju ka ardhur një letër me ftesën e Qendrës integruese komunale. Në atë ftesë është shkruar termi për një bisedë këshilluese.



2. Ju lutemi ejani së bashku me fëmijën tuaj në atë termin. Sillni me vete të gjitha pasaportat dhe (mundësisht) vërtetimin tuaj mbi lajmërimin e vendbanimit. Në qoftë se keni dëftesa shkollore të fëmijës suaj, atëherë ju lutemi sillni edhe ato me vete.



3. Nëse ka mundësi, ejani ju lutemi me dikë që tashmë e flet deri diku gjermanishten. Personeli i Qendrës integruese komunale po ashtu po e kërkon ta gjejë një përkthyes.




Në Qendrën integruese komunale

4. Personeli dëshiron të dijë se kur është lindur fëmija juaj, cilat gjuhë i flet dhe sa gjatë deri tash ka shkuar në shkollë. Do të ju pyesin po ashtu se a di të flasë fëmija juaj tashmë gjermanisht ose jo. Në Rrethin Varendorf [Warendorf] ka klasa, ku gjermanishtja mund të mësohet jashtëzakonisht shpejt. Për klasat e tilla do të ju informojmë gjërësisht gjatë bisedës këshilluese.



5. Pastaj Qendra integruese komunale ia dërgon shkollës përkatëse informatat në lidhje me fëmijën tuaj.



Pas bisedës këshilluese


6. Në ndërkohë juve ju vjen termi për kontroll në Entin shëndetësor.

Kjo është me rëndësi, për arsye se çdo fëmijë duhet të kontrollohet para se të shkojë në shkollë. Për ta caktuar terminin ju ndihmon Qendra integruese komunale.



7. Qendra integruese komunale e Rrethit Varendorf [Warendorf] ju lajmëron se në cilën shkollë ka për të shkuar fëmija juaj. Tash ai mund të shkojë në shkollë.

Ju dëshirojmë shumë sukses!



Idee: Stadt Köln, Bilder: Kreis Warendorf, Texte: z. T. übernommen vom KI Kreis Lippe. Vielen Dank für die freundliche Unterstützung!